



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 2108 /2022
Data: 22.03.2022

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e dytë -II- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 28.02.2022 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: z.**Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës, **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtore për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh për Administratë), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Hisni Luri** (Drejtore për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Bajrush Laçi** (Shef i Zyrës Ligjore), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Ajete Berisha** (Udhëheqëse e Personelit), **Ilir Kaloshi** (Përfaqësues i NPL "Pastrimi"), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim). Kryesuesi i Kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.
3. Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2021.
4. Raporti finansiar për vitin 2021.
5. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2021.
6. Propozim vendim për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale në komunën e Hanit të Elezit.
7. Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2022.
8. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2022.
9. Plani i punës së komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara për vitin 2022.
10. Raporti finansiar për vitin 2021 i N.P.L "Pastrimi" sh.a.
11. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.
12. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pika e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- është kthyer normaliteti dhe situata është e qetë. Në dy javët e fundit kemi vetëm një rast pozitiv, ndërsa sa i përket rasteve nga data 06.01.2022 deri më 28.02.2022 kanë qenë 128 raste pozitive. Procesi i vaksinimit është duke shkuar në mënyrë të rregullt dhe deri më tanë doza të administruara janë 9668 doza. Me dozë të parë janë 4808, me dozë të dytë janë 4395 dhe me dozë të tretë janë 465 , ndërsa 159 nxënës janë vaksinuar. Nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

3. Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2021.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- mandatin e kemi marr në muajin dhjetor të vitit 2021 dhe nuk kemi diçka nga puna që mund të ju kishim thënë shumë konkrete përvèç dy donacioneve të cilat i kemi pranuar nga KFOR-i Italian , ndërsa të tjerat kanë qenë takime me vizitorë të ndryshëm. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje

Qamush Brava thekson:- sa i përket raportit i kam përgatitur katër faqe për gabimet të cilat janë në raport dhe do t'i përcjelli në imell në sekretari dhe pastaj ua shpérndanë drejtorëve për me i bëre përmirësimet. Materiali është dërguar dhe faqet nuk kanë numra përvèç deri te faqja njëzet e katër. Faqe tre te kryetari potencohej se gjatë muajit të kaluar është bëre pranim dorëzimi i dy donacioneve nga kontingjenti i KFOR-it Italian pra në cilin muaj është bëre për shkak se ne jemi në muajin shkurt është dashur të potencohej data, muaji dhe viti. Te zyra ligjore aktet janë shënuar për gjashtë muaj dhe është raport vjetorë, duhet të janë për dy mbëdhjetë muaj. Te Drejtoria e Administratës aktet janë paraqitur në periudhë të caktuar 9931, ndërsa përqindja i del 96 % që do të thotë nuk e ke mbledhur. Te drejtoria e financave gabime ka shumë të cilat do t'i përcjelli me imell adresë për shkak se gabime ka edhe në planifikim të buxhetit. Te shpenzimet sipas kodeve ekonomike ka gabime. Te drejtoria e zhvillimit ekonomik në tabelar shënon që 303 akte i ka nënshkruar , ndërsa në tabelarin tjetër shënon 240.

Mehmet Ballazhi thekson:- është raport i vitit kaluar dhe nëse janë këto gabime janë përcjellë si raport i ish Kryetarit të Komunës dhe nëse ke diçka që ne e kemi punuar është diçka tjetër.

Qamush Brava thekson:- është shënuar se Kryetari i Komunës nuk na ka lënë asgjë por e keni reportin gjashtë mujorë të Kryetarit të Komunës dhe janë tre muaj nëse potenconi që nuk ju ka lënë asgjë, mirëpo gjashtë mujorin e keni të gatshëm, përllogaritjet nga ky ekzekutiv janë bëre e jo nga Kryetari i kaluar.

Mehmet Ballazhi thekson:- shënimet i kemi marr ashtu siç janë përllogaritur më herët ashtu siç i keni bërë me shpenzime me tabelarë, me punë dhe me të gjitha dhe për atë nuk i kemi hyrë asaj pjese hiq, ty ishe kryeses i kuvendit dhe ke mundur me u marr për me i përmirësuar. Nga ish Kryetari i Komunës nuk kam marr asnje material dhe kompjuterin e kam marr zero zero dhe çdo material që më është dashur mu e kam marr prej drejtorive dhe punëtorëve që i ka brenda drejtorisë secili prej stafit vetë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapres sipas agjendës.

4. Raporti finansiar për vitin 2021.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe besoj që e keni shqyrtuar por për njëmbëdhjetë muaj të viti 2021 nuk mbaj asnje përgjegjësi për shkak se është i përgatitur nga ish drejtori , ndërsa për muajin dhjetorë jam e hapur për diskutime.

Qamush Brava thekson:- te raporti finansiarë që në fillim është shënuar drejtori por duhet të jetë drejtoresha. Faqe pesë me përqindje janë të gjitha gabim dhe nuk dua që të ju marr kohë por do të i përcjelli me imell adresë. Faqe gjashtë përsëri te buxheti përfundimtarë ka gabime në shifra por do t'i përcjelli me imell të përmirësuara. Faqe shtatë te planifikimet përsëri ka gabime. Te drejtoria e arsimit faqe trembëdhjetë shuma prej 16156.00 € është planifikuar , ndërsa janë shpenzuar 6156 € , mirëpo në raport është potencuar se qind për qind janë shpenzuar. Te shpenzimet sipas kodeve ekonomike ka shumë gabime. Faqe tetëmbëdhjetë te shpenzimet e varrimit në përshkrim janë marr shënimet për vitin 2020, ndërsa bëhet fjalë për vitin 2021. Te kodi i shpenzimeve të varrimit dhe te kodi për ushqim dhe pije janë marr shënimet e vitit 2020. Në faqe 22 dhe 23 në vebfaqe të komunës janë shifra tjera dhe në raport janë shifra tjera.

Lindita Ballazhi thekson:- raporti i cili është i publikuar në vebfaqen e komunës janë të përfshirë edhe donacionet e në material nuk janë të përfshira dhe për atë nuk përputhen shumat.

Resul Suma thekson:- raporti finansiarë është i punuar shumë mirë përveç disa gabimeve teknike. E përgëzojë Drejtoreshën për Buxhet dhe Financa për shkak se ka bërë një punë të mirë dhe i ka kryer edhe shujtat për vitin 2018-2019 të cilat kanë qenë të humbura për shkak se nuk ka pasur menaxhim të mirë të buxhetit nga qeverisja e kaluar. Drejtoresha është duke u angazhuar dhe duke i bërë mirë planifikimet që pjesa e mbetur për pagesën e shujtave me u kryer deri në muajin prill të këtij viti.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit njëzëri.

U MIRATUA RAPORTI FINANCIAR PËR VITIN 2021

5. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2021.

Kryesuesi thekson:- përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk ka. Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit njëzëri.

U MIRATUA RAPORTI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2021

6. Propozim vendim për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale në komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- këtë propozim e kemi përcjell në kuend duke u bazuar në rregulloren për organizimin dhe funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Hanit të Elezit. Komisioni duhet të jetë prej shtatë anëtarëve, katër nga subjektet e ndryshme politike, një nga ekzekutivi i komunës, një përfaqësues nga shoqëria civile dhe një nga administratori përkatës.

Nora Xhoni thekson:- para se me u miratuar rregullorja për bashkëpunim me fshatra kanë qenë trembëdhjetë këshilla të fshatrave, ndërsa në proporcion me banorë tash i kemi katër këshilla dhe në KPF kam kërkuar që me u specifikuar se kush bënë pjesë në ato katër këshilla të fshatrave.

Natyra Kalisi thekson:- në rregullore janë të paraqitura edhe dy shtojca dhe në shtojcën e parë paraqitet komplet lista e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, ndërsa shtojca e dytë është propozimi për këshillat e fshatrave. Në këshillin e parë përfshihen Hani i Elezit, Uji i Thartë, Lagjja e Re, Laçt, Pusteniku, Dimca. Në këshillin e dytë përfshihen Seçishta dhe Kriveniku. Në këshillin e tretë përfshihen Goranca dhe Rezhanca dhe në këshillin e katërt përfshihen Paldenicë, Dermjak, Neçafçë dhe Vertomica.

Kryesuesi thekson:- kërkoi nga subjektet që emrat për anëtarë të komisionit t'i përcjellin në sekretari të kuvenit. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLAVE LOKALE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT

7. Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Qamush Brava thekson:- në mandatin e kaluar çdo herë e keni përmendur problemin e qenve endacak, ndërsa në plan nuk e keni përfshirë.

Mehmet Ballazhi thekson:- në takimin të cilin e kemi pasur me Asociacionin e Komunave e kemi diskutuar edhe këtë çështje por nuk na lejohet me Ligj që çështjen e qenve endacak për t'i trajtuar. Sa i përket planit të punës së KKSB-së krahas pikave që janë planifikuar mund edhe ndonjë pikë që është e rëndësisë së veçantë por nuk kam diçka konkretë për këtë çështje për shkak legjisacionit që nuk na lejon për t'i trajtuar.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLANI I PUNËS SË KËSHILLIT KOMUNALE PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2022

8. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Qamush Brava thekson:- si plan është për me u përshëndetur për shkak se rregullisht e kemi pasur problematike edhe te komitetet konsultative dhe te komiteti për komunitete sepse gjithë këto mundohen që me marr planin e kuvenit të komunës. Kryesues i komitetit vërejta që është zgjedhur një person që është me përvojë dhe për herë të parë e kam parë një plan që ja ka përcjell kompetencave të veta dhe e përshëndes këtë plan dhe kështu duhet të veprojnë edhe komitet e tjera

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLANI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2022

9. Plani i punës së komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLANI I PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA PËR VITIN 2022

10. Raporti finansiar për vitin 2021 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Qamush Brava thekson:- njëra nga ndërmarrjet që jam mburrë dhe që ka qenë rentabile është kjo ndërmarrje e cila është komunale me aksione të komunës qind për qind. Komisioni i aksionarëve është zgjedhur nga kuvendi i komunës dhe konkursi është shpallë për kryeshef dhe ndërmarrja e ka bordin, komisionin e aksionarëve dhe drejtori ekzekutiv i ndërmarrjes. Sa kam qenë kryesues i kuvendit të komunës nuk kam lejuar me u bërë diçka jashtë ligjit, kështu që bëjë thirrje për atë që është anti ligjore si kuvend dalim keq dhe atë që mundeni me evituar duhet ta eviton për shkak se kemi mundësi me evituar sepse i kemi tre aksionarë sepse aksionarët e zgjedhin bordin dhe bordi e zgjedhë ekzekutivin. Komisioni i aksionarëve është zgjedhur dhe bordi e ka bërë një shkelje kur e ka shpallur konkursin dhe kemi mundësi që përmes aksionarëve me shkarkuar bordin. Nëse bordi ka bërë shkelje ligjore më mirë është me shkarkuar për mos me bërë veprime më tutje. Mund ta shikoni në disa veb faqe të komunave që kur ka pasur kësi shkelje është dënuar edhe bordi nga 1500 euro çdo anëtarë. Ligji e parashev që për pozitën të cilën e keni shpallë duhet të jetë me fakultet por edhe për bordin e parashev që duhet të jenë me fakultet dhe së paku prej tyre duhet të jenë me përgatitje akademike. Në ligjin për ndërmarrje publike parashihet te neni 17.3 e parashev që të jetë me fakultet e jo me shkollë të mesme. Nëse e keni dikend me shkollë të mesme shpesh e keni dëgjuar që ish Kryetari i Komunës z.Rufki Suma është duke i dërguar në Universum për me i marr fakultetet dhe qoni edhe ju ne ta marrin dhe të jenë me fakultet. Jemi duke i dhënë tridhjetë bursa për studentët të cilët studiojnë dhe ata tridhjetë bursa mos i jepni se me shkollë të mesme po u pranojkan. Nëse për atë pozitë të cilën e keni shpallur e zgjedhim personin i cili është me shkollë të mesme kemi me u bërë vendi i parë në Kosovë ku drejtorin ekzekutivë me tridhjetë punëtorë e përzgjedhim me shkollë të mesme, mirëpo kemi shumë persona me fakultet dhe me master e merreni kënd dëshironi e jo me bërë kësi shkelje sepse jam asamblistë dhe e dua këtë vend dhe nuk dua me pa në këtë gjendje .

Mehmet Ballazhi thekson:- çështjen e procedurave të cilat i ka udhëhequr bordi ti së paku duhesh me i ditë dhe me ua sqaruar edhe të tjerëve se ajo çështje është në kompetencë të bordit dhe në mënyrë decidive potencoher që bordi e shkarkon dhe bordi e emëron. Nëse ka shqetësim janë rrugë tjera ligjore mundeni me vazhduar se nuk është çështja a e zgjedhim ne se nuk e kemi shpall konkurs, nuk kemi bërë komision dhe nuk kemi bërë asgjë por është çështja e bordit që e ka udhëhequr këtë proces dhe ju mund t'i drejtoheni bordit për shqetësimet të cilat i paraqitët e jo neve personalisht apo dikujt këtu sepse bordi është përgjegjës për këto çështje . Sa i përket çështjes së fakulteteve tu kisha lutar mos me hyrë për shkak se për çështjet e fakulteteve dhe shkollave të mesme i caktuar shoferë pa leje kjo ka ndodh kur ju keni qenë në qeverisje

Qamush Brava thekson:- çdo herë jeni thirr për ndryshime por unë jam ithtarë që ndryshimet me i mbajtur dhe ju keni qenë asambleistë katër vite dhe në diskutimet që i keni parashtruar si opozitë kam menduar që mos jemi ne gabim, por në këtë çështje mendoj që është gabim dhe ju duhet ta ndryshoni sepse jeni thirr në ndryshime dhe këtë gabim nuk dua që t'ju lejoj që ta bëni. Anëtarët e bordit kanë deklaruar ndryshe për thirrjet të cilat i kanë pasur dhe aksionarët i kemi dhe ata duhet ta thërrasin bordin për me i treguar që është gabim sepse kemi mundësi me parandaluar për shkak se i kemi dërguar aksionarët.

Mehmet Ballazhi thekson:- unë e kuptoj shqetësimin tënd dhe pajtona me çdo shqetësim të gjithë kujt dhe ndiqni rrugën ligjorë dhe a është mirë a është keq është çështje tjetër. Është mirë që ta potenconi atë që është faktike sepse nëse potencojmë me imaginata të emrave të personave shkon shumë gjatë se çka thonë personat për ty unë mendojë që janë çështje të rrugëve që unë nuk merrem sepse ky është edhe ndryshimi të cilin po mundohem me instaluar në këtë qeverisje katër vjeçare që duhet të na ipet kohë deri në fund të mandatit të cilët kanë me vlerësuar të gjithë se a kemi vepruar mirë apo nuk kemi vepruar mirë.

Kryesuesi thekson:-a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas rendit të punës.

11. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- vitin e kaluar kanë qenë 18 aplikime për legalizim dhe të gjitha janë pajisur me leje të legalizimit. Nga këto legalizimi janë inkasuar të hyra në shumë prej 2468 euro, e që në raport me vitin 2020 i bien afér 2000 euro më shumë. nëse keni ndonjë pyetje rreth legalizimit mund të parashtroni.

Nora Xhoni thekson:- ku qëndron ankesa e qytetarëve të cilët nuk aplikojnë.

Nexhmedin Daci thekson:- ankesat më të mëdha janë te shërbimet e shtrenjta kadastrale për shkak se për legalizimit të objektit kërkohet një raport i gjeodetit që kushton një euro për metër katrorë dhe qytetarët kanë probleme edhe me prona por mendoj që ndikim ka pasur edhe koronavirusi.

Refet Kalisi thekson:- a egzistonë mundësia që matjet me u kryer me gjeodetët të cilët i ka komuna sepse mendojë që do të ishte një lehtësim për qytetarët.

Nexhmedin Daci thekson:- me ligj nuk lejohet që gjeodeti i komunës me kryer shërbime për prona individuale.

Kryesuesi thekson:-a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas rendit të punës.

12. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Qamush Brava thekson:- e keni bërë një ftesë për debat publik dhe ju e dini që ftesa për debat publik duhet të jetë 14 ditë dhe ju e keni bërë për nesër, e unë mendoj që kjo është shkelje dhe ndikon në performancë.

Nexhmedin Daci thekson:- ne kemi drejtë me i ftuar qytetarët për me u konsultuar dhe mund të jetë diskutim publik apo punëtori dhe në tekstu nuk shënon që në bazë të ligjit apo statutit por poenta është se jemi duke punuar te projekti i parkut të qytetit dhe e kemi parë të arsyeshme që me i ftuar qytetarët ata të cilët duan me qenë pjesëmarrës në mënyrë që me i marr propozimet e tyre.

Qamush Brava thekson:- drejtor ju e dini që ne jemi kujdesur që debatet të jenë së paku 14 ditë. Drejtoria e urbanizmit dhe drejtori e shërbimeve publike i ka dhënë përgjigjet, ndërsa te drejtoria e arsimit e kam kërkuar një përgjigje për vendimin për ndërrimin e vendit të punës dhe keni potencuar që e keni bërë në bazë të ligjit të punës dhe arsimit pas universitarë por udhëzimi administrativ 14/2011 për rregullimin e marrëdhënieve të punës, pastaj neni tre pika tre në pajtim me nenin tetë paragrafi dy i Ligjit të Punës 03/2012 dhe po të analizohen këto transferet e brendshme nëse ka dy e më shumë kandidatë duhet të shpallet konkurs. Unë mund të ju sjelli një aktgjykim ku një komunë e ka humbur rastin në gjykatë pas ankesave që ka pasur prej tre kandidatëve. Çështja e shujtave ka qenë propozim i Qeverisë Kurti që me u dhënë nga klasa e parë deri në klasën e pestë dhe është e ndarë vlera e qarkores buxhetore për shujtat e nxënësve 24 330 € dhe mjetet financiare janë të ndara në tri drejtori të shkollave. Konsultonu me Drejtoreshën e Financave dhe me drejtorin e ish kaluar sepse mjetet financiare janë por duhet të iniciohen procedurat. Mjetet financiare të cilat janë ndarë për këtë çështje nuk mund të shfrytëzohen diku tjetër.

Hisni Luri thekson:- transferi është bërë në kuadër të të njëjtës shkollë sepse është paralele e ndarë e shkollës filllore "Ilaz Thaçi" dhe kërkesat për transfer ju kanë drejtarish drejtorit të më hershmë që ka qenë kërkesë jashtë afatit kohorë sepse ju kanë drejtarish drejtorit, ndërsa kërkesën të cilën e kam pasur ka qenë e paraleles amë dhe ke të drejtë në qoftë se ishin bërë ankesat në kohë të rregullt për shkak se i kam konsultuar ligjet dhe besoj se e kemi marr vendimin e duhur. Sa i përket shujtave e kam parë qarkoren buxhetore dhe mjetet ishin grand por unë nuk kam gjet vendim që e ka lënë ish Qeverisja e kaluar që specifikon se këto mjete ndahen për shujtat

Qamush Brava thekson:- po që se të ishin bërë ankesa te çështja e transferim rastin keni pasur me humbur, ndërsa sa i përket mjetet financiare për shujtat janë dhe mund t'i inicioi procedurat por duhet të konsultoheni me drejtorinë e financave.

Hyriete Isufi thekson:- vërejtje kam për festën e shtatëmbëdhjetë shkurtit sepse nuk ka keni dërguar ftesë si asamblistë me marr pjesë në manifestim. Sa i përket planit të punës së komitetit për komunitete ja bëjë me die z. Qamush Brava se edhe vitin e kaluar ka qenë ndryshe prej viteve të tjera po ashtu edhe në vitin 2020 ka qenë ndryshe që do të thotë ka qenë plan krejt ndryshe.

Kryesuesi thekson:- sa i përket ftesës është vërejtje me vend por puna e kovidit po na sjellë telashe dhe shpresojmë se në manifestimet e tjera do të bëhet salla edhe te shtëpia e kulturës dhe vërejtjen të cilën e potencove do ta kem parasysh, për ndryshe edhe unë nuk kam mundur me shkuar për shkak se nëse ftohet dikush duhet të sigurohet ulësja, mirëpo për shkak të kovidit ftesa ka qenë publike dhe ata që kanë dashur me shkuar kanë mundur të janë pjesëmarrës.

Ajnure Thaqi thekson:- shkolla filllore "Ilaz Thaçi" nuk ka psikologë dhe duke marr parasysh që kemi nevojë shumë për psikolog në shkollë çka keni menduar me bërë për këtë çështje.

Xhevahir Dernjani thekson:- duke marr parasysh që nxënësit e shkollës filllore e mësojnë gjuhën Gjermane pesë vite dhe kalojnë në shkollë të mesme dhe fillojnë në gjuhën Franceze, e jo duke e anashkaluar atë gjuhë por pse mos të jetë edhe gjuha Gjermane duke ju bashkangjitur prej shkollës filllore. Sa i përket drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale është mirë që të analizohen rastet dhe të i ndihmohet asaj familje që e meriton pra që vërtetë ka nevojë. Drejtoria për urbanizëm t'i shikon mundësit në të ardhmen që të bëjë renovimin e banesave kolektive për shkak se janë dëmtuar.

Resul Suma thekson:- kërkoj sqarim prej drejtorisë për shëndetësi sepse në intervistën që e ka dhen ka potencuar se drejtori ka bërë keq menaxhim .

Refet Kalisi thekson:- kërkoj informacion për projektin te varrezat e qytetit se a është bartur për vitin 2022. A ka parashtuar kërkesë kompania "Sharrcem" për zgjerimin e hapësirës te guri në fshatin Seçishtë.

Nexhmedin Daci thekson:- ka dështuar kompania dhe ne ja kemi ndërprerë kontratën dhe e ka paguar gjobën kompania dhe në këtë vit përsëri duhet me shpall. Kompanisë "Sharrcem" ja kemi dhënë pëlqimin për zgjerim sepse komuna me plan zhvillimorë nuk ka ndonjë projekt në atë pjesë, ndërsa për çështje të bashkëpunimit Kryetari i Komunës besoj që do të takohet.

Hisni Luri thekson:- çështja e psikologut është e nevojshme por për shkak të stafit të cilin e kemi të mbingarkuar nuk mundemi me pranuar por si kërkesë e kemi parasysh. Për çështjen e gjuhës gjermane duhet të iniciohet nga këshilli drejtues i shkollës kjo çështje për shkak se e kanë të përcaktuar me planin zhvillimorë të shkollës.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- sa i përket çështjes së intervistës shumë mirë e dimë që mediat kur duan të ngrisin apo kur duan ta humbin imazhin si institucion në këtë rast siç kanë vepruar ka qenë një keq interpretim apo keqkuptim nga ana e intervistës të cilën e kam dhënë sepse në asnje moment gjatë intervistës nuk e kam nënvylerësuar profesionalizmin e tij dhe kontributin që ka dhënë për komunën tonë ish drejtori, mirëpo thjeshtë kanë qenë keq menaxhim nga ana administrative e tij që shumë çështje janë iniciuar nga ana e komunës dhe ato çështje kanë mbetur tek QKMF-ja në neglizhencë , që na lenë për me nënkuptuar që stafi i mesëm ka pasur shumë kompetencia se sa ish drejtori.

Ibadete Kalisi thekson:- a ekziston mundësia që nxënësve të fshatit Seçishtë dhe Gorancë me ju kryer pagesa e udhëtimit nga ana e komunës.

Hanumshahe Dibrani thekson:- a egzistonë mundësia me u shtruar me zhavorr pjesa e rrugës së fshatit Gorancë pasi që është dëmtuar.

Qamush Brava thekson:- krahas shujtave të arsimit a keni planifikuar me i kryer pagesën edhe për shujtat e stafit politikë vetëm për një vit.

Lindita Ballazhi thekson:- për stafin e arsimit do të kryhen në muajin mars dhe prill ndërsa për stafin politik do t'i shohim mundësit në të ardhmen.

Mehmet Ballazhi thekson:- e dini që kemi një buxhet të planifikuar nga viti i kaluar dhe jemi duke u munduar pjesën e arsimit me kryer për shkak se kontrata kolektive na detyron, ndërsa sa i përket shujtave për stafin politik nuk e di që ka ndonjë buxhet të planifikuar por do të shikojmë mundësitë me çështje të mjeteve financiare. Sa i përket rrugës Gorancës takim kam pasur me punë kryesin dhe shpresoj që si të del koha me filluar punimet e jo vetëm me shtruar me zhavor për shkak se po dëmtohet me një herë .

Hisni Luri thekson:- sa i përket kryerjes së pagesës për nxënësit e fshatit Seçishtë dhe Gorancë nuk kemi të planifikuar mjete financiare.


Hyriete Isufi thekson:- e kemi diskutuar çështjen e pajisjes me llaptop për anëtarët e kuvendit por është mirë ta bisedojmë me gjithë dhe të pajisemi me tableta për shkak se janë më praktik dhe më pak kushtojnë. Në të ardhmen nëse pranohet ndonjë psikologë të jetë për gjithë shkollat e komunës.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në ora 12:30

Procesmbajtësi

Aymi Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

